



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Nr. 882 prot.

Tiranë, më 11.06.2025

**NJOFTIM PËR SHPREHJE INTERESI PËR TË QENË ANËTAR I KOMISIONIT
KOMBËTAR TË PËRZGJEDHJES PËR TND-në**

Në zbatim të Vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, dhe në përputhje me pikat 3, 4, 5 dhe 6 të kreut II të këtij vendimi, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) shpall thirrjen për shprehje interesi për 1 (një) anëtar që do të përfaqësojë ASPA-n në Komisionin Kombëtar të Përzgjedhjes për TND-në.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

- të kenë arsim të lartë të nivelit të dytë;
- të kenë përvojë pune për të paktën 5 (pesë) vite në administratën publike në pozicione drejtuese, por jo në funksione politike dhe në momentin e kandidimit të mos jetë nëpunës civil;
- të mos kenë qenë anëtarë të asnjë partie politike për të paktën 3 (tre) vitet e fundit nga data e kandidimit për anëtar të KKP-së;
- të mos kenë qenë të dënuar penalisht për kryerjen ndonjë vepre penale;
- të kenë cilësi të larta morale dhe profesionale;
- të mos kenë masa disiplinore në fuqi;
- të mos jenë larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 33, Kati i 6-të, Tiranë:

- Diplomën/diplomat e arsimit të lartë (fotokopje e noterizuar);
- Jetëshkrimin (CV);
- Vërtetim nga punëdhënësi aktual ose ai i mëparshëm, ku të specifikohet vjetërsia në punë dhe nëse janë marrë masa disiplinore;
- Dëshminë e penalitetit;
- Deklaratë personale që vërteton se nuk ka qenë anëtar i një partie politike gjatë 3 (tre) viteve të fundit;
- Vërtetim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që provon se nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet e përgjithshme apo vendore të zhvilluara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nën siglën e ndonjë partie politike.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 26 qershor 2025.